



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AVOKATI I POPULLIT
Seksioni i Veçantë

Adresa: Bulevardi: "Zhan D'Ark" Nr.2
Tiranë, Shqipëri

Tel/Fax: +355 4 2380 300/315
E-mail: ap@avokatipopullit.gov.al
www.avokatipopullit.gov.al

Nr. Prot.
Nr. Dok.202200513/4

Tiranë ____/____/2022

Lënda: *Rekomandim për marrjen e masave ligjore për shpejtimin e gjykimit të çështjeve që kanë objekt njohjen e viteve të punës, njohjen e vërtetësisë apo pavërtetësisë së dokumentit për përfitimin e pensionit të pleqërisë, duke iu garantuar shtetasve këtë të drejtë, në kuadër të procesit të rregullt ligjor.*

KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR

Tiranë

GJYKATËS SË APELIT TIRANË

Tiranë

GJYKATËS SË APELIT SHKODËR

Shkodër

Të nderuar,

Në insitucionin e Avokatit të Popullit, në vijimësi kanë ardhur në rritje rastet e ankesave lidhur me të drejtën për një proces të rregullt ligjor, e në veçanti lidhur me gjykimin e çështjeve gjyqësore, brenda një afati të arsyeshëm, në gjykatat e apelit.

Një pjesë e ankesave të paraqitura në insitucionin tonë kanë të bëjnë me zvarritjet e gjykimeve në gjykatat e apelit të vendit, kryesisht me objekt njohjen e viteve të punës ose përfitimin e pensionit të pleqërisë, me palë të paditur Institutin e Sigurimeve Shoqërore apo drejtoritë rajonale përkatëse.

Konkretisht, evidentojmë disa ankesa të paraqitura dhe proceset gjyqësore:

Në Gjykatën e Apelit Tiranë:

-Ankesa e shtetasit **S.M** i cili sqaron se Gjykata e Rrethit Gjyqësor Mat ka vendosur njohjen e viteve të punës si shofer në kooperativë bujqësore.

Ndërkohë, përfaqësuesi i Drejtorisë Rajonale të Sigurimeve Shoqërore pranë Prefekturës së Qarkut Dibër ka paraqitur ankim në Gjykatën e Apelit Tiranë. Prej vitit 2019 dhe deri aktualisht kjo çështje nuk është shqyrtuar nga kjo gjykatë.

Po ashtu, shtetasi shprehet se është i sëmurë me disa probleme shëndetësore.

Sjellim në vëmendje se kjo çështje ka tashmë tre vjet e regjistruar në këtë gjykatë.

-Ankesa e shtetasit **A.V** i cili referon se në Gjykatën e Apelit Tiranë është regjistruar çështja lidhur me përfitimin e pensionit të pleqërisë. Ka mbi dy vjet e regjistruar në gjykatë dhe ende nuk ka një datë për gjykimin e saj.

Qytetari ankohet se nuk merr fare pension pleqërie dhe nuk ka të ardhura të tjera për të përballuar jetesën, si dhe është i sëmurë me diabet. Ai sqaron se ka paraqitur dy kërkesa për përshpejtim pranë Gjykatës së Apelit Tiranë, por nuk është njoftuar nëse janë shqyrtuar apo jo.

Në Gjykatën e Apelit Shkodër:

-Ankesa e shtetasi **L.K**, i cili sqaron se në Gjykatën e Apelit Shkodër është regjistruar çështja numër 21266-00072-50-2020 në datë 13.01.2020, me objekt njohjen e viteve të punës në Ndërmarrjen Bujqësore Pukë.

Ka paraqitur kërkesë për përshpejtim gjykimi në këtë gjykatë dhe nuk është pranuar.

-Ankesa e shtetasit **M.GJ**, i cili sqaron se në Gjykatën e Apelit Shkodër është regjistruar çështja nr.1115 regj.them, datë 10.03.2020 me:

Të paditur: DRSSH Kukës

Me objekt: Njohje e vërtetësisë së dokumentit

Mungesat e theksuara në këto gjykata, për shkak të shkarkimit të gjyqtarëve nga reforma në drejtësi dhe moszëvendësimit të tyre me gjyqtarë të tjerë, kanë bërë që të akumulohet një numër tepër i lartë i dosjeve që presin radhën e gjykimit me vite.

Në kuadër të hetimit administrativ, të kryer nga institucioni ynë pranë gjykatave të apelit, çështjet e lartpërmendura kanë rezultuar të regjistruara prej më shumë se dy vitesh. Ndërkohë, edhe pse ka kaluar afati 2 vjeçar i parashikuar në nenin 399/2, pika 1(b) të Kodit të Procedurës Civile, ende nuk është planifikuar një datë për gjykimin e tyre.

Mosgjykimi i çështjeve të lidhura me pensionet e pleqërisë brenda një afati të arsyeshëm, cenon të drejtën për një proces të rregullt ligjor.

Po ashtu, passjell pasoja të konsiderueshme për këtë kategori me të ardhura të pakta dhe të pamjaftueshme. Pensionistët janë një kategori një duhet t'iu njihen dhe të përfitojnë nga të drejtat e tyre në kohë, për shkak të vetë moshës së thyer, si dhe faktit që një pjesë e tyre vuajnë nga probleme shëndetësore, shpeshherë madhore.

Për më tepër një pjesë jo e vogël e tyre jetojnë në kushtet që nuk kanë familjarë për t'i ndihmuar dhe e vetmja e ardhur e jetesës mbetet pensioni i pleqërisë. Por kur edhe ky pension nuk përfitohet, për shkak të zvarritjeve me vite në sistemin gjyqësor, atëherë është njësoj sikur kësaj kategorie t'i kemi hequr çdo shpresë për të jetuar. Pra, pasojat janë tepër të rënda si për palët në proces, po ashtu dhe për dhënien e drejtësisë.

Konventa Evropiane për të Drejtat e Njeriut, trajton të drejtat qytetare e politike themelore, si ndalimi i torturës, e drejta për një proces të rregullt dhe liria e të shprehurit.

Nga ana tjetër, Karta sociale evropiane dhe Karta sociale evropiane e rishikuar trajtojnë të drejtat sociale themelore, si e drejta për punë, liria e organizatave, e drejta për marrëveshje kolektive, e drejta për siguri dhe higjienë në punë, e drejta për mjete të përshtatshme formimi profesional, e drejta për sigurime shoqërore, e drejta për asistencë sociale e mjekësore, e drejta për shërbime sociale dhe e drejta e punonjësve migruar për mbrojtje e asistencë.

KEDNJ-ja dhe Karta Sociale Evropiane (si dhe Karta e rishikuar) janë akte ndërkombëtare që garantojnë së bashku për këdo që marrin në mbrojtje jo vetëm një jetë normale, pa ndërhyrje të papërligjor të shtetit, por edhe një jetë të denjë dhe, në është e mundur, autonome.

Karta Sociale Evropiane u hap për nënshkrim më 1961 dhe hyri në fuqi më 1965. Ajo është një "instrument etalon". Për ta ratifikuar, palët kontraktuese duhet të zgjedhin të paktën dhjetë nene, ku pesë prej tyre minimumi duhet të jenë nene që përbëjnë bërthamën qendrore. Në këtë bërthamë nenesh përfshihet e drejta për sigurimet shoqërore dhe e drejta për asistencë sociale e mjekësore.

Karta sociale evropiane e rishikuar u hap për nënshkrim më 1996 dhe hyri në fuqi më 1999. Ajo ndryshon disa të drejta ekzistuese të parashikuara nga Karta sociale evropiane dhe fut një seri të drejtash të reja, ndër të cilat e drejta për

mbrojtje kur humbet vendin e punës, e drejta për mbrojtje kundër varfërisë dhe përjashtimit shoqëror, si dhe e drejta për strehim. Ajo synon të garantojë standarde më të larta dhe të ndërtojë një politikë globale për të luftuar probleme të tilla si varfëria.

Parimi bazë i cili përshkon të dyja kartat mbetet **barazia në trajtim**. Parimi i barazisë synon të zhdukë çdo diskriminim, të drejtpërdrejtë apo të tërthortë.

Gjithashtu, vlen të përmendim se Shqipëria dhe 192 shtete të tjera anëtare të Kombeve të Bashkuara në shtator 2015, miratuan Axhendën 2030 për Zhvillim të Qëndrueshëm. Axhenda e vitit 2030 është një kornizë globale 15-vjeçare e përqendruar në 17 Objektiva të Zhvillimit të Qëndrueshëm (SDG), 169 synime dhe mbi 230 tregues.

Ajo përbën një angazhim global novator për t'i dhënë fund varfërisë dhe për ta futur botën në rrugën e qëndrueshme drejt një zhvillimi gjithëpërfshirës (synon një botë pa varfëri dhe uri, me arsim cilësor, mbulim shëndetësor universal, arritje të barazisë gjinore dhe fuqizim të grave dhe vajzave, dhe me një mjedis të qëndrueshëm). Objektivat e zhvillimit të qëndrueshëm synojnë të përqendrohen në koordinimin e politikave kombëtare për një vizion të përbashkët ndaj njerëzimit. Ato mbështeten në përpjekjet e mëparshme për zbatimin e axhendës për uljen e varfërisë të njohur si Objektivat e Zhvillimit të Mijëvjeçarit (OZhM).

Në vlerësim tonë, e drejta e gjykimit brenda një afati të arsyeshëm ligjor është një ndër të drejtat themelore të qytetarëve shqiptarë. Për këtë arsye, e drejta e gjykimit brenda një afati të arsyeshëm nuk është dhe nuk duhet të mbetet një e drejtë apo garanci deklarative, por është standard kushtetues, i garantuar dhe sanksionuar në aktet që përcaktojnë të drejtat dhe liritë themelore të njeriut, si në nivel ndërkombëtar (neni 6 i Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut), ashtu edhe në të drejtën e brendshme (neni 42 i Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë¹).

Kodi i Procedurës Civile, i cili përcakton rregulla të detyrueshme, të njëjta dhe të barabarta, për gjykimin e mosmarrëveshjeve civile e të mosmarrëveshjeve të tjera, me ndryshimet e vitit 2017, i ka kushtuar vëmendje të veçantë çështjes së respektimit të afatit të arsyeshëm të gjykimit, duke e trajtuar këtë institut në një kre të veçantë. Në dispozitën e nenit 399/2, pika 1 të këtij ligji përcaktohet se:

“1. Afate të arsyeshme të përfundimit të hetimit, gjykimit apo ekzekutimit të një vendimi të formës së prerë, për qëllimet e përcaktuara në nenin 399/1, do të konsiderohen:

¹ Në nenin 42 të Kushtetutës parashikohet se:

1. Liria, prona dhe të drejtat e njohura me Kushtetutë dhe me ligj nuk mund të cenohen pa një proces të rregullt ligjor.
2. Kushdo, për mbrojtjen e të drejtave, të lirive dhe të interesave të tij kushtetues dhe ligjorë, ose në rastin e akuzave të ngritura kundër tij, ka të drejtën e një gjykimi të drejtë dhe publik brenda një afati të arsyeshëm nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme e caktuar me ligj.

- a) në gjykimin administrativ në shkallën e parë dhe në apel, përfundimi i gjykimit brenda një viti nga fillimi i tij në secilën shkallë;
- b) në gjykimin civil në shkallë të parë përfundimi i procesit të gjykimit brenda dy viteve, në gjykimin civil në apel brenda dy vjetëve; dhe gjykimin civil në Gjykatën e Lartë, brenda dy vjetëve;.....”

Me rëndësi në analizën tonë është sjellja në vëmendje e vendimit nr.78, datë 30.05.2019 të Këshillit të Lartë Gjyqësor “Për kalendarin e shqyrtimit të çështjeve në Gjykatën e Apelit”, në të cilin përcaktohet se:

“Caktimi i datës dhe orës së gjykimit të çështjes së ardhur mbi ankim të palës/palëve, bëhet nga gjyqtari relator, në përputhje me kalendarin e tij të shqyrtimit të çështjeve, duke marrë për bazë radhën sipas kohës së ardhjes së dosjeve në Gjykatën e Apelit.”

Por, në pikën 4 të tij përcaktohet:

“Për një çështje, për të cilën Kodi i Procedurës Civile apo një ligj i veçantë nuk ka përcaktuar afat për gjykimin e saj, në caktimin e datës dhe orës së shqyrtimit, në përputhje me kalendarin e shqyrtimit të çështjeve (kalendarin me datat e planifikuara të gjykimeve), gjyqtari relator mban parasysh afatin e arsyeshëm sipas nenit 399/2, të Kodit të Procedurës Civile dhe/ose sipas këtij neni në lidhje me nenin 109, pika 4, të Ligjit nr.38/2017, datë 30.3.2017.”

Përsheptimi i shqyrtimit të çështjes mbi kërkesë të palëve, për shkak të natyrës dhe kategorisë specifike të çështjes ose për shkaqe veçanërisht të rënda dhe të motivuara, kur kjo nuk vjen në kundërshtim me ligjin.

3.1 Çështje të tilla, sipas natyrës, janë:

g. çështjet me objekt vërtetim fakti juridik të vjetërsisë në punë ose njohjen e vërtetësisë apo pavërtetësisë së dokumentit me pasoja juridike sa i përket përfitimit të pensionit;

Pra, edhe në vetë vendimin e Këshillit të Lartë Gjyqësor çështjet që kanë të bëjnë me vërtetim fakti juridik ose njohjen e vërtetësisë apo pavërtetësisë së dokumentit, me pasoja përfitimin e pensionit, hyjnë në sferën e atyre çështjeve që duhen gjykuar në mënyrë të përsheptuar.

Njëkohësisht, me miratimin e ligjit nr.169/2020 “Për njohjen si periudhë sigurimi për efekt përfitimi nga sigurimet shoqërore të kohës së punësimit në ish-kooperativat bujqësore”, është patur si qëllim thjeshtëzimi i hetimit administrativ dhe shmangia e procedurave të panevojshme dhe të zgjatura gjyqësore, për të vërtetuar fakte që nuk kanë nevojë të provohen dhe që mund të verifikohen lehtësisht nga organi administrativ.

Miratimi i këtij ligji erdhi si domosdoshmëri për shkak të praktikave abuzive të administratës publike në fushën e sigurimeve shoqërore, që në çdo rast të mungesës së dokumentacionit i adresonin subjektet që pretendonin të drejtën e pensionit, të vërtetonin faktin e vjetërsisë në punë në ish-kooperativat bujqësore.

Pra, nga njëra anë, vërtetonin gjyqësisht faktin e vjetërsisë në punë në ish-kooperativat bujqësore, por nga ana tjetër, proceset e gjata gjyqësore, në të gjithë shkallët e gjykimit dhe të pajustificuara, për provueshmërinë e fakteve botërisht të njohura, rrezikonte humbjen në thelb të së drejtës së pensionit, si e drejtë themelore kushtetuese me rëndësi jetike për shtresa vulnerabël të shoqërisë.

Një ndër parimet bazë të procedimit administrativ është parimi i eficiencës dhe deburokratizimit, që nënkupton zhvillimin dhe përfundimin e procedimit administrativ sa më shpejtë të jetë e mundur, brenda afateve të përcaktuara në ligj, në mënyrë që të arrihet çfarë është e nevojshme për një rezultat të ligjshëm (neni 18 i KPA).

Kolegji i Gjykatës së Lartë vlerëson se ligji nr.169/2020 nuk solli risi në atribuimin për herë të parë të juridiksionit administrativ mbi hetimin e fakteve juridike me pasoja për palën në procedurën administrative, por e thjeshtëzoi atë dhe kufizoi diskrecionin e organeve vendimmarrëse (administrative dhe gjyqësore), mbi vlerësimin e faktit juridik të vjetërsisë në punë, duke i hequr palës që pretendon të drejtën e pensionit, një barrë të paarsyeshme për të paraqitur prova në procedimin administrativ dhe gjyqësor.

Proceset e gjata gjyqësore, në të gjitha shkallët e gjykimit dhe të pajustificuara, për provueshmërinë e fakteve botërisht të njohura, rrezikonin humbjen në thelb të së drejtës së pensionit, si e drejtë themelore kushtetuese me rëndësi jetike për shtresa vulnerabël të shoqërisë².

Neni 6 i KEDNJ-së³ zë një vend të rëndësishëm në tërësinë e të drejtave që garanton kjo konventë. Një gjykim i drejtë në çështje civile dhe penale është një element bazë i parimit

² Për më shumë:

Vendimi nr.00-2021-706, datë 08.04.2021 i Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë.

³ Sipas nenit 6 “E drejta për një proces të rregullt” të KEDNJ-së:

1. Në përcaktimin e të drejtave dhe detyrimeve të tij civile ose të çdo akuze penale kundër tij, çdo person ka të drejtë që çështja e tij të dëgjohet drejtësisht, publikisht dhe brenda një afati të arsyeshëm nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme. Vendimi duhet të jepet publikisht, por prania në sallën e gjykatës mund t'i ndalojë shtypit dhe publikut gjatë tërë procesit ose gjatë një pjese të tij, në interes të moralit, të rendit publik ose sigurisë kombëtare në një shoqëri demokratike, kur kjo kërkohet nga interesat e të miturve ose mbrojtja e jetës private të palëve në proces ose në shkallën që çmohet tepër e nevojshme nga gjykata, kur në rrethana të veçanta publiciteti do të dëmtojte interesat e drejtësisë.
2. Çdo person i akuzuar për një vepër penale prezumohet i pafajshëm, derisa fajësia e tij të provohet ligjërisht.
3. Çdo i akuzuar për një vepër penale ka të drejtat minimale të mëposhtme:
 - a) të informohet brenda një afati sa më të shkurtër, në një gjuhë që ai e kupton dhe në mënyrë të hollësishme, për natyrën dhe për shkakun e akuzës që ngrihet ndaj tij;
 - b) t'i jepet koha dhe lehtësitë e përshtatshme për përgatitjen e mbrojtjes;
 - c) të mbrohet vetë ose të ndihmohet nga një mbrojtës i zgjedhur prej tij ose, në qoftë se ai nuk ka mjete të mjaftueshme për të shpërblyer mbrojtësin, t'i mundësohet ndihma ligjore falas kur këtë e kërkojnë interesat e drejtësisë;
 - d) të pyesë, ose të kërkojë që të merren në pyetje dëshmitarët e akuzës dhe të ketë të drejtën e thirrjes dhe të pyetjes të dëshmitarëve në favor të tij, në kushte të njëjta me dëshmitarët e akuzës;

të shtetit të së drejtës. Midis garancive që lidhen direkt ose indirekt me gjykatën janë ndër të tjera: publiciteti i gjykimit (seancat e hapura dhe shpallja e vendimit publikisht), mënyra e zhvillimit të rregullt të seancave gjyqësore, konkretisht elementë të tillë si: barazia e armëve, afati i arsyeshëm, arsyetimi i vendimeve etj.

Në legjislacionin e brendshëm shqiptar, ashtu sikurse në disa legjislacione evropiane, në zbatim të detyrimeve të përcaktuara nga GJEDNJ, janë parashikuar edhe mjete të veçanta ankimi, me qëllim përshpejtimin e proceseve gjyqësore. Një nga këto mjete është edhe padia e veçantë e parashikuar në Kodin e Procedurës Penale dhe Kodin e Procedurës Civile lidhur me zgjatjen e procesit tej afatit të arsyeshëm. Me anë të këtij ankimi pala e interesuar ka mundësinë për të ndikuar drejtpërdrejt në një përshpejtim të procesit. Me anë të kësaj padie, qytetari jo vetëm konstaton tejzgjatjen pa arsye të procesit, por mund të marrë dhe dëmshpërblim (nëse e kërkon) për vonesën e shkaktuar. Vendimi në këtë rast urdhëron gjykatën kompetente ta shqyrtojë çështjen sa më parë. Natyrisht, në disa raste tejzgjatja e procesit gjyqësor ka shkaqe objektive. Në një rast të tillë kjo padi mund të bëhet shkak për evidentimin e arsyeve konkrete dhe ndoshta edhe për eliminimin e tyre nga organet kompetente. Pra, ky mjet duhet konsideruar me efekt parandalues, në rast të tejzgjatjes pa shkak të procesit, pra që çdo individ ka një mjet efikas që do t'i vijë në ndihmë.

E drejta e gjykimit brenda një afati të shpejtë dhe të arsyeshëm është jo vetëm një garanci për mbrojtjen e palëve nga zvarritjet e paarsyeshme të procedurave, por mbi të gjitha garanton se brenda një afati të arsyeshëm pala kërkuuese do të përfitojë eventualisht nga të drejtat që i janë mohuar, duke i mundësuar asaj siguri juridike në raport me pozitën procedurale. Për më tepër, gjykimi brenda një afati të arsyeshëm, përveçse është një standard të cilin organi gjyqësor ka detyrimin ta respektojë *apriori*, është mbi të gjitha një standard që vlerësohet në mënyrë të veçantë për secilin rast konkret, nisur nga specifika, kompleksiteti, tërësia e të drejtave të shkelura apo të pretenduara, etj.

Mosgjykimi i çështjes gjyqësore brenda një afati të arsyeshëm, në veçanti i atyre çështjeve të lidhura me të drejtën e pensionit, jo vetëm cenon të drejtën e ankuesit për një proces të rregullt ligjor, por për më tepër, zvarrit eventualisht përfitimin e tij në kohë reale.

Dëshirojmë të theksojmë se institucioni i Avokatit të Popullit vlerëson faktin se në gjykatat e apelit ka një numër të konsiderueshëm të çështjeve të paraqitura për gjykim, gjë që çon në ngarkesë voluminoze të punës së gjyqtarëve, shoqëruar kjo edhe me vakancat e shkaktuara si rrjedhojë e reformës në drejtësi (procesit të vettingut)⁴.

Kjo ngarkesë e lartë sasiore e gjyqtarëve, në mënyrë të veçantë në Gjykatën e Apelit Tiranë ose Gjykatën Administrative të Apelit është faktor që ndikon drejtpërdrejt në vonesa të

e) të ndihmohet falas nga një përkthyes, në qoftë se nuk kupton ose nuk flet gjuhën e përdorur në gjyq.

⁴ Sipas Raport Progresit për Shqipërinë për vitin 2021, në vitin 2020, Shqipëria ka pasur 307 gjyqtarë me kohë të plotë (10.8 për 100,000 banorë) dhe 300 prokurorë me kohë të plotë (10.5 për 100,000 banorë). Sipas Komisionit European për Efiçencën në Drejtësi (CEPEJ), mesataret evropiane janë 21 gjyqtarë/12 prokurorë për 100,000 banorë.

theksuara të shqyrtimit të çështjeve gjyqësore. Jemi gjithashtu koshientë se ngarkesa që po përballohet nga gjyqtarët në këtë kohë është e jashtëzakonshme dhe thujse e papërballueshme. Nisur dhe nga ankesat që janë paraqitur në institucionin e Avokatit të Popullit, theksojmë se çështja kërkon ndërhyrje, pasi vonesat dëmtojnë qytetarët vulnerabël në vend, në nevojë thelbësore jetësore.

Nga ana tjetër, jemi të vetëdijshëm se këto janë çështje me natyrë dhe kategori specifike që duhet të gjykohen me prioritet sipas vendimit nr.78, datë 30.05.2019 të Këshillit të Lartë Gjyqësor *“Për kalendarin e shqyrtimit të çështjeve në Gjykatën e Apelit”*.

Po ashtu në këtë linjë, Udhëzimi nr.1, datë 26.05.2022 i Këshillit të Ministrave *“Për përcaktimin e rregullave për heqjen dorë nga rekursat e depozituara nga administrata shtetërore nën përgjegjësinë e Këshillit të Ministrave, të pashqyrtuara nga Gjykata e Lartë, për disa çështje me natyrë civile dhe administrative”*, udhëzon administratën shtetërore, nën përgjegjësinë e Këshillit të Ministrave të heqin dorë nga rekursat e paraqitura përpara hyrjes në fuqi të udhëzimit, kundër vendimeve të gjykatave të apelit dhe të Gjykatës Administrative të Apelit, për çështjet me natyrë civile dhe administrative me objekt:

- a) zgjidhjen e mosmarrëveshjeve që lindin nga marrëdhëniet e punës;
- b) ***njohjen/vërtetimin e vjetërsisë në punë, si dhe vërtetësinë/pavërtetësinë /njohjen e të dhënave të dokumentit (librezëpunë, regjistër themeltar, listëpagesa, libër pagash, vërtetim e të tjerë) etj...***

Gjykata Kushtetuese lidhur me kërkesat për konstatimin e cenimit të së drejtës kushtetuese për një proces të rregullt ligjor, si pasojë e moszhvillimit të gjykimit të çështjes brenda një afati të arsyeshëm, ka theksuar se arsyeshmëria e zgjatjes së procesit duhet të vlerësohet mbi bazën e kriterëve të përcaktuara në jurisprudencën e GJEDNJ-së, nën dritën e rrethanave të veçanta të çështjes, duke pasur parasysh sidomos kompleksitetin e çështjes, sjelljen e kërkuarit, sjelljen e autoriteteve, si dhe rrezikun që passjell për kërkuarin kjo tejzgjatje e afateve të gjykimit⁵. Për rrjedhojë, Gjykata çmon se për të arritur në konkluzionin nëse në rastin konkret jemi përpara cenimit të së drejtës për një proces të rregullt ligjor, duhet të vlerësohet analiza e secilit prej elementeve të sipërcituara.

Për gjithë sa parashtruar, në mbështetje të pikës 3, të nenit 63, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë ku përcaktohet: *“Avokati i Popullit ka të drejtë të bëjë rekomandime dhe të propozojë masa kur konstaton shkelje të të drejtave dhe të lirive nga administrata publike”*, si dhe në ligjin nr.8454, datë 04.02.1999 *“Për avokatin e Popullit”*, i ndryshuar, neni 21/b në të cilin parashikohet: *“Avokati i Popullit paraqet rekomandime për marrje masash për vënien në vend të së drejtës së shkelur tek organi administrativ që ka shkaktuar shkeljen”*:

⁵ Vendim i Gjykatës Kushtetuese nr.69 datë 17.11.2015.

REKOMANDOJMË:

- Marrjen e masave të nevojshme nga Gjykata e Apelit Tiranë dhe Gjykata e Apelit Shkodër për respektimin e vendimit nr.78, datë 30.05.2019 të Këshillit të Lartë Gjyqësor “Për kalendarin e shqyrtimit të çështjeve në Gjykatën e Apelit”, me qëllim shpejtimin e gjykimit të çështjeve që kanë objekt njohjen e viteve të punës, njohjen e vërtetësisë apo pavërtetësisë së dokumentit për përfitimin e pensionit të pleqërisë, duke iu garantuar shtetasve këtë të drejtë, në kuadër të procesit të rregullt ligjor.
- Analizimin e këtyre rasteve nga KLGJ dhe nxjerrjen e një udhëzimi për sjelljen në vëmendje të gjykatave të apelit gjykimin me prioritet të çështjeve të lidhura me përfitimin e pensionit të pleqërisë dhe faktin e njohjes së viteve të punës për efekt pensioni.

Për qëndrimin që do të mbani dhe masat që do merrni në zbatim të këtij rekomandimi, na vini në dijeni brenda afatit ligjor 30 ditor, të parashikuar në nenin 22 të ligjit nr.8454 datë 04.02.1999 “Për Avokatin e Popullit”, i ndryshuar.

Duke besuar në mirëkuptimin dhe bashkëpunimin tuaj,

AVOKATI I POPULLIT

Erinda BALLANCA